
RREGULLORJA NR. 2001/6
PËR SHOQËRITË TREGTARE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin e dhënë atij me Rezolutën 1244 (1999) të datës 10 Qershor 1999;

Duke marrë parasysh Rregulloren Nr. 1999/1 të datës 25 Korrik 1999, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, si dhe ndryshimet që i janë bërë, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë;

Me qëllim të themelimit të regjimit ligjor për formimin, mirëmbajtjen, dhe përfundimin e aktivitetit, bizneseve individuale, ortakërive, dhe korporatave në Kosovë.

Shpall sa vijon:

Kapitulli 1
Dispozita të Përgjithshme

Neni 1
Objekti, Zbatimi dhe Fusha e Veprimtarisë

1.1 Objekti i kësaj rregulloreje është krijimi i mundësive për themelimin e rregullt të shoqërive tregtare fitimprurëse në Kosovë; caktimi i pronësisë, përgjegjësia dhe kompetencat për të marrë vendime, mënyrat, mjetet dhe procedurat për organizimin, strukturën dhe administrimin e tyre; mënyrat, mjetet dhe procedurat për përfundimin dhe likuidimin e tyre; të drejtat dhe detyrimet që u takojnë; dhënia e kompetencave dhe autorizimeve personave përgjegjës dhe organeve përkatëse (dhe pasuesit e tyre) për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.

1.2 Kjo rregullore ka objekt rregullimin ligjor vetëm për shoqëritë tregtare fitimprurëse në Kosovë.

Neni 2
Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet vijuese, përveç rasteve kur nga vetë konteksti kërkohet në mënyrë të qartë ndryshe apo kur vetë rregullorja jep tjetër kuptim:

“Përfaqësues” është personi i autorizuar nga një person tjetër për të kryer veprime në emër të tij.

“Shoqëri Tregtare” është çdo person apo grup personash që merren me veprimtari tregtare.

“Kapital” është pasuria e luajtshme apo e paluajtshme, e prekshme apo e paprekshme që zotërohet nga shoqëria tregtare dhe shfrytëzohet për nxjerrje fitimi.

“Veprimtari Tregtare” është ushtrimi i çdo veprimtarie ekonomike të lejueshme me qëllim fitimi, pavarësisht nëse ky qëllim është deklaruar shprehimisht apo jo.

“Krijimi me ligj” nënkupton mënyrën e shtrirjes të të drejtave ose përgjegjësive tek një person i caktuar nga vetë zbatimi në një situatë faktike konkrete rregullave të përcaktuara me ligj.

“Person” nënkupton një person fizik apo juridik.

Në këtë rregullore, njëjësi përfshin shumësin dhe shumësi njëjësin, përveç rastit kur nga konteksti kërkohet ndryshe. Përemri vetor “ai” nënkupton “ajo” dhe fjala “atij” nënkupton “asaj” dhe “kësaj”, me përjashtim kur nga konteksti kërkohet ndryshe.

Referencat që u bëhen “neneve” në këtë rregullore janë referenca të neneve të kësaj rregulloreje, përveç rastit kur parashikohet ndryshe.

Neni 3

Llojet e Shoqërive Tregtare

3.1 Shoqëritë tregtare mund të jenë Biznese Individuale, shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri aksionere ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

3.2 Bizneset individuale dhe shoqëritë kolektive mund të krijohen në bazë të ligjit. Nëse një person fizik apo një ose më shumë persona fizikë ose juridikë merren me tregti por nuk u përmbahen kërkesave të formimit dhe regjistrimit të parashtruara në këtë rregullore lidhur me shoqëritë komandite, shoqëritë aksionere ose shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar këto do të konsiderohen përkatësisht biznese individuale dhe shoqëri komandite për sa i përket marrëdhënieve me kreditorët dhe personat e tretë.

Neni 4

Qëllimet e Lejueshme, Rregulli i Gjykimit Ekonomik

4.1 Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari që nuk është e ndaluar me ligj.

4.2 Drejtorët dhe nëpunësit e shoqërive tregtare duhet të përpiqen në maksimum për të përmbushur qëllimet e shoqërisë së tyre. Megjithatë, asnjë anëtar i organit kompetent drejtues

nuk përgjigjet për ndonjë veprim apo mosveprim nëse vendimi i marrë për të vepruar apo për të mos vepruar del nga shqyrtimi i të dhënave të arsyeshme dhe lidhet me pikësynimet dhe qëllimet e shoqërisë tregtare përkatëse në mënyrë racionale.

Kapitulli 2

Bizneset Individuale

Neni 5

Përgjegjësia e Pronarit

5.1 Personi fizik që kryen veprimtari tregtare, jo si përfaqësues apo si nëpunës i një shoqërie tregtare, vepron si biznes individual. Personi fizik që kryen veprimtari si një biznes individual mban përgjegjësi për të gjitha borxhet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij me gjithë pasurinë e tij.

5.2 Në asnjë procedurë gjyqësore, arbitrazhi, falimentimi apo ekzekutimi vendimi, gjykata apo organi i arbitrazhit nuk mund të ndajë pasurinë e pronarit të biznesit individual në pasuri që ai e përdor me qëllim ushtrimin e veprimtarisë tregtare dhe në pasuri të cilën pronari e përdor për qëllime personale, të shtëpisë, apo familjes, përveç rasteve kur marrëveshja në të cilën bazohet ngritja e padisë përkatëse e parashikon një gjë të tillë, ose kur paditësi bie dakord më vonë me këtë, ose kur rregullorja apo ligji për ekzekutimin e vendimeve apo falimentimit parashikon përjashtimin e një pjese të caktuar të pasurisë.

Neni 6

Statuti Juridik i Bizneseve Individuale

Asnjë biznes individual nuk është person juridik pavarësisht nëse është i regjistruar, ka leje për të zhvilluar veprimtari ekonomike të një lloji të caktuar, apo mban emër tregtar.

Neni 7

Regjistrimi i Emrave Tregtarë

7.1 Personi fizik që merret me tregti në formën e një biznesi individual duhet të tregojë në dokumentat e regjistrimit të paraqitura sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/8 datë 29 Shkurt 2000, mbi Regjistrimin Provizor të Bizneseve në Kosovë ose rregulloreve të tjera të aplikueshme të gjithë emrat tregtar që përdor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare. Në qoftë se pas depozitimit të kërkesës së regjistrimit ai përdor emra të tjera tregtare, duhet ta pasqyrojë këtë në deklaratën e regjistrimit.

7.2 Regjistrimi i një emri tregtar sipas nenit 7.1 nuk krijon të drejtë marke tregtare. Megjithatë, përdoruesi i një emri tregtar që është regjistruar ka prioritet mbi atë emër tregtar ndaj të gjithë përdoruesve të tjerë, të paregjistruar apo të regjistruar më pas me këtë emër. Gjkata mund të urdhërojë përdorimin e emrit tregtar të paregjistruar ose të regjistruar pas personit të parë që ka regjistruar një emër tregtar.

Kapitulli 3

Shoqëria Kolektive

Neni 8

Natyra e Shoqërisë Kolektive, Përgjegjësia e Ortakëve

8.1 Shoqëria kolektive është shoqëri tregtare e cila themelohet me bashkimin e dy apo më shumë personave me qëllim ushtrimin e një veprimtarie tregtare. Personat që bashkohen në këtë mënyrë për themelimin e shoqërisë quhen “ortakë të pakufizuar”. Shoqëria konsiderohet e themeluar nga vetë egzistenca e një bashkimi të tillë, pavarësisht nëse ortakët e formalizojnë shoqërinë me anë të regjistrimit, marrëveshjes me shkrim apo në ndonjë mënyrë tjetër.

8.2 Ortakët mbajnë përgjegjësi kolektive dhe individuale për borxhet dhe detyrimet e tjera të shoqërisë kolektive me tërë pasurinë e tyre. Shoqëria nuk është person juridik por ajo mund të lidhë kontrata, të ketë pasurinë e saj dhe të padisë apo të paditet në emër të saj, si dhe në emër të ortakëve të saj. Çdo gjykim kundër shoqërisë është i zbatueshëm si ndaj pasurisë së përbashkët të shoqërisë ashtu edhe ndaj pasurisë private të të gjithë ortakëve. Dispozitat e nenit 5.2 zbatohen ndaj ortakëve me analogji.

8.3 Dispozitat e nenit 7 që kanë të bëjnë me përdorimin dhe regjistrimin e emrave tregtar të bizneseve individuale zbatohen njëjloj edhe për shoqëritë kolektive.

Neni 9

Marrëveshja e Shoqërisë Kolektive

9.1 Themelimi i shoqërive kolektive nuk kërkon marrëveshje me shkrim edhe pse ortakët në rast se duan mund ta lidhin një të tillë. Asnjëri nga ortakët i cili nuk është palë e marrëveshjes së shoqërisë nuk mund të detyrohet nga ajo.

9.2 Rregulli i përgjithshëm është që palët në marrëveshjen e shoqërisë mund të ndryshojnë çdo dispozitë të kësaj rregulloreje që ka të bëjë me marrëdhëniet mes ortakëve, por ata nuk mund të ndryshojnë ato dispozita që kanë të bëjnë me të drejtat e palëve të treta. Nenet e Kapitujve 3 dhe 4 që parashtrojnë rregulla jo të detyrueshme ose “përjashtuese” kanë frazën “përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë” ose gjuhë të ngjashme; nenet në të cilat nuk përdoret kjo gjuhë përcaktojnë rregulla detyruese. Dispozitat jo të detyrueshme të kësaj rregulloreje zbatohen kur ortakët nuk e zbatojnë marrëveshjen, kur marrëveshja është e paefektshme, ose kur marrëveshja nuk rregullon çështjen për të cilën lind konflikti.

Neni 10

Kompetencat Përfaqësuese të Ortakëve

Secili ortak i pakufizuar është përfaqësues i ortakëve të tjerë të shoqërisë për qëllime të tregtisë së zakonshme të shoqërisë dhe secili ortak ka kompetenca për të shkaktuar detyrime monetare ndaj ortakëve të tjerë në lidhje me veprimtarinë e zakonshme tregtare të shoqërisë. Veprimtaria e zakonshme tregtare e shoqërisë përfshin vetëm veprimet në kuadër të biznesit me të cilin shoqëria merret. Marrëveshjet në të kundërt janë të paefektshme ndaj palëve të treta por të efektshme midis ortakëve.

Neni 11 Administrimi i Shoqërisë Kolektive

11.1 Mosmarrëveshjet midis ortakëve për sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me shoqërinë kolektive zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash, përveç rastit kur në marrëveshjen e shoqërisë është parashikuar ndryshe. Votimi mund të bëhet në çfarëdolloj metode, por duhet që të gjithë ortakëve u jepet njoftim i arsyeshëm për votimin në lidhje me një çështje të caktuar.

11.2 Çdo ortak i shoqërisë kolektive ka të drejtë të barabartë vote dhe administrimi me ortakët e tjerë, përveç rastit kur në marrëveshjen e shoqërisë parashikohet ndryshe. Megjithatë, marrëveshja e shoqërisë mund të krijojë klasa të ndryshme ortakësh, mund tu japë atyre të drejta të ndryshme votimi dhe mund t'i mohojë një ortaku të drejtën për të votuar ose për të marrë pjesë në një mënyrë tjetër në administrimin e shoqërisë.

11.3 Natyra e veprimtarisë tregtare të shoqërisë nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e të gjithë ortakëve.

Neni 12 Ndarja e Fitimit

12.1 Çdo ortak i shoqërisë kolektive ka të drejtën e një pjese të barabartë në çdo fitim, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

12.2 Shoqëria kolektive duhet të bëjë ndarjen e fitimit të paktën një herë në vit, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

Neni 13 Përgjegjësia për Humbjet

13.1 Çdo ortak në shoqërinë kolektive duhet të japë kontributin e tij për përballimin e barabartë të humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria tregtare e shoqërisë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

13.2 Çdo ortak është i detyruar të japë kontributin e nevojshëm për të mbuluar humbjet sapo këto humbje t'i bëhen të ditura ndonjërit prej ortakëve, ndërsa dhe me prishjen e shoqërisë, të gjithë ortakët duhet të japin kontribute të barabarta për përmbushjen e kërkesave të personave të tretë dhe për mbulimin e shpenzimeve në një mënyrë tjetër, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

Neni 14
Të Drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve ndaj Njeri - Tjetrit

14.1 Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë:

- (a) çdo ortak në shoqërinë kolektive i detyrohet ortakëve të tjerë të mos u bëjë konkurrencë veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- (b) asnjë ortak në shoqërinë kolektive nuk mund të jetë njëkohësisht ortak apo aksioner në një shoqëri tregtare e cila është në konkurrencë me shoqërinë kolektive;
- (c) asnjë ortak në shoqërinë kolektive nuk mund të mbajë pozitë drejtuese ose të kryejë shërbime administrimi në një shoqëri tregtare, që është në konkurrencë me shoqërinë kolektive. Ortaku quhet se ka “pozitë drejtuese” ose “kryen shërbime administrimi” në një shoqëri tregtare kur ai ortak merr apo ushtron ndikim në marrjen e vendimeve lidhur me veprimet e shoqërisë tregtare konkurruese;
- (d) çdo ortak në shoqërinë kolektive detyrohet të veprojë në mirëbesim ndaj ortakëve të tjerë; duke përfshirë detyrimin e dhënies së informacionit, ruajtjen e fshehtësisë dhe shmangien e konflikteve të interesave; asnjë ortak nuk mund të shfrytëzojë mundësitë tregtare të shoqërisë;
- (e) çdo ortak i cili i shkel detyrimet ndaj ortakëve të tjerë, duhet t’i kompensojë ortakët e tjerë për dëmet dhe fitimet e humbura që rrjedhin nga kjo;
- (f) secili ortak mundet që interesat e tij fitimprurëse në shoqëri, duke përfshirë dhe të drejtat e tij për ndarjen e fitimit të shoqërisë, t’ia kalojë një personi të tretë vetëm me pëlqimin e gjithë ortakëve të tjerë; si dhe
- (g) një person mund të bëhet ortak në shoqërinë ekzistuese vetëm me pëlqimin unanim të gjithë ortakëve të kësaj shoqërie. Pranimi i një ortaku të ri nuk ndikon në vazhdimësinë e shoqërisë

14.2 Kushdo që bëhet ortak i shoqërisë kolektive ekzistuese merr përsipër përgjegjësitë e kësaj shoqërie duke përfshirë dhe përgjegjësitë e mëparshme në mënyrë të barabartë me të gjithë ortakët ekzistuesë. Marrëveshjet në të kundërt janë të paefektshme ndaj palëve të treta por kanë efekt ndërmjet ortakëve.

14.3 Ortaku që jep dorëheqjen ose largohet nga shoqëria në një mënyrë tjetër, mbetet përgjegjës për borxhet e shoqërisë që kanë lindur para datës së dorëheqjes apo largimit nga shoqëria në mënyrë tjetër.

Neni 15
Pasuria e Shoqërisë Kolektive

15.1 Shoqëria kolektive mund të zotërojë pasuri nën emrin me të cilin zhvillon veprimtarinë tregtare ose me çdo emër me të cilin regjistrohet sipas rregullores së UNMIK-ut 2000/8 apo rregullore tjetër të aplikueshme.

15.2 Çdo ortak ka interes pasuror të barabartë në gjithë pasurinë e shoqërisë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e krijimit të shoqërisë kolektive.

Neni 16 Shpërbërja e Shoqërisë Kolektive

16.1 Shoqëria kolektive shpërbëhet me vdekjen e ndonjërit prej ortakëve, dorëheqjen apo përjashtimin e një ortaku nga shoqëria, likuidimin ose falimentimin e ndonjërit prej ortakëve që është person juridik, përfundimin e afatit të caktuar në marrëveshjen për krijimin e shoqërisë, ose kur veprimtaria tregtare e shoqërisë bëhet e paligjshme, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

16.2 Ortaku konsiderohet që ka dhënë dorëheqje nga shoqëria kolektive, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, kur:

- (a) ortaku nuk paguan me kohë kontributin ndaj shoqërisë;
- (b) ortaku informon ndonjë ortak tjetër se ai jep dorëheqje nga shoqëria; ose
- (c) Ortaku kërkon vullnetarisht mbrojtje formale nga kreditorët e tij ose gjykohet i paaftë për të shlyer borxhet sipas ligjeve të falimentimit në fuqi, ose
- (d) Ortaku që është shoqëri aksionere apo formë tjetër e korporatës, likuidohet.

16.3 Me vdekjen e një ortaku që është person fizik ose me likuidimin e cilitdo ortaku që është person juridik, e tërë pasuria e shoqërisë i nënshtrohet procedurës së parashikuar me ligj për përcaktimin e statusit apo cedimin e pasurisë së ortakut të vdekur apo të likuiduar; pavarësisht nga kjo ortakët e mbetur të shoqërisë mund të bien dakord të formojnë një shoqëri të re në marrëveshje me gjykatën apo administrator tjetër të punëve apo pasurisë së ortakut të vdekur ose të likuiduar. Me shpërbërjen e shoqërisë ortakët gjithashtu mund të bien dakord për cedimin e interesave pasurorë të ortakut në pasurinë e shoqërisë.

16.4 Shpërbërja e shoqërisë nuk i shuan pretendimet e palëve të treta kreditore ndaj ortakëve të shoqërisë kolektive të shpërbërë, dhe as kërkesat e ortakëve ndaj njëri tjetrit.

Neni 17 Likuidimi Vullnetar i Shoqërisë Kolektive

17.1 Shoqëria kolektive mund të likuidohet me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve të saj, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë. Likuidimi është subjekt i dispozitave të ligjeve të falimentimit në fuqi.

17.2 Në përputhje me ligjet e falimentimit në fuqi, ortakët duhet të emërojnë një person të tretë të paimterësuar si likuidues përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë. Ky likuidues merr titull mbi pasurinë e shoqërisë me qëllim që të zbatojë procedurën e likuidimit

dhe merr të gjitha kompetencat e ortakëve. Likuiduesi ka të drejtë të marrë në posedim të gjithë librat e llogarive dhe të dhënat e shoqërisë.

17.3 Brenda njëzetën ditëve nga data e caktimit të tij, likuiduesi duhet të vendosë paraprakisht nëse shoqëria ishte në gjendje aftësie paguese në kohën kur ai filloi të veprojë si likuidues dhe nëse shitja e pasurive të shoqërisë mund të sjellë të ardhura të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të vlefshme të të gjithë kreditorëve. Nëse likuiduesi vlerëson se shoqëria është e paaftë për të paguar në kohën që ai filloi të veprojë si likuidues, apo që shitja e pasurisë së shoqërisë nuk mund të sjellë të ardhura të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të vlefshme të të gjithë kreditorëve, ai duhet të fillojë menjëherë procedurën sipas Ligjit të Falimentimit. Nëse likuiduesi nuk është në gjendje të marrë vendimet e sipërpërmendura apo nuk e bën këtë brenda kohës së caktuar, çështja e likuidimit do t'i kalohet për gjykim gjykatës apo organit tjetër kompetent për gjykimin e rasteve të falimentimit.

17.4 Nëse likuiduesi vlerëson se shoqëria është e aftë për të paguar në kohën kur ai filloi të veprojë ose nëse shitja e pasurisë së shoqërisë mund të nxjerrë fitime të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të vlefshme të të gjithë kreditorëve, likuiduesi duhet, jo më vonë se tridhjet ditë pas emërimit të tij, të publikojë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, një njoftim mbi emërimin e tij si likuidues, të ngjashëm me njoftimin publik fillestar që kërkohet të publikohet nga likuiduesi në procesin e falimentimit; njoftimi duhet të deklarojë shprehimisht se kreditorët e shoqërisë mund të kërkojnë përmbushjen e kërkesave të tyre nga ortakët individualë të shoqërisë.

17.5 Pas publikimit të njoftimit fillestar sipas kërkesës së nenit 17.4, likuiduesi duhet të bëjë një listë të të gjithë pasurisë së shoqërisë dhe të zbatojë procedurën e likuidimit në përputhje me ligjin dhe rregullat mbi falimentimin, me kusht që likuiduesi të mos ketë kompetenca përjashtuese. Në kuptim të këtij neni “kompetenca përjashtuese” nënkupton kompetencat për shpalljen e veprimeve tregtare mashtruese apo të paramenduara në dëm të kreditorëve dhe në këtë mënyrë të kërkojë rikthimin e pasurisë apo paratë e përdorura në këtë veprim tregtar.

Kapitulli 4

Shoqëria Komandite

Neni 18

Themelimi, Përgjegjësia e Ortakëve

18.1 Shoqëria komandite është shoqëri tregtare e përbërë nga të paktën një ortak i pakufizuar dhe një ortak i kufizuar. Ortakët e pakufizuar kanë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë komandite, ndërsa ortakët e kufizuar mbajnë përgjegjësi deri në kufirin e kontributit të tyre në shoqërinë komandite, si dhe në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me këtë rregullore. Dispozitat e Kapitullit 3 zbatohen për shoqërinë komandite dhe ortakët e saj të pakufizuar, përveç kur parashihet ndryshe në këtë Kapitull.

18.2 Shoqëria komandite themelohet me regjistrimin e aktit të themelimit të shoqërisë komandite në agjensinë e cila është e autorizuar të regjistrojë shoqëritë tregtare. Agjensia

përkatëse duhet të lëshojë certifikatën e regjistrimit që është provë e pakontestueshme për themelimin e shoqërisë komandite. Nëse akti i themelimit i shoqërisë komandite nuk është regjistruar si i tillë, atëherë shoqëria komandite nuk është krijuar dhe të gjithë personat që kanë investuar kapital ose janë lidhur në një mënyrë tjetër me qëllim të zhvillimit të një tregtie të përbashket janë ortakë të pakufizuar me përgjegjësi të pakufizuar.

18.3 Çdo person në shoqërinë komandite mund të jetë ortak i pakufizuar ose i kufizuar. Nëse ortaku i vetëm i pakufizuar në shoqërinë komandite është person juridik, ai duhet të themelohet dhe të regjistrohet në mënyrë të ligjshme në përputhje me ligjin në fuqi.

18.4 Akti i themelimit i shoqërisë komandite duhet të përfshijë emrin e plotë dhe adresën e vendbanimit të secilit ortak të pakufizuar që është person fizik si dhe emrin dhe selinë e secilit ortak që është person juridik.

18.5 Shoqëria komandite duhet të mbajë listën e ortakëve të kufizuar si dhe shumën e interesave të tyre në shoqërinë komandite. Një informacion i tillë mund të jepet pa pëlqimin e ortakut të kufizuar në fjalë vetëm sipas urdhrit të gjykatës ose në një mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

18.6 Çdo ortak i kufizuar duhet të ketë bërë derdhjen e plotë të kontributit tij në kohën e regjistrimit të aktit të themelimit të shoqërisë komandite.

18.7 Ortaku i pakufizuar në shoqërinë komandite mund të hapë një proces gjyqësor në emër të shoqërisë komandite dhe në emër të të gjithë ortakëve të kufizuar të kësaj shoqërie për të detyruar ortakun e kufizuar të bëjë pagesën e kontributit të tij në shoqërinë komandite që nuk e ka bërë në kohë. Ortaku i kufizuar i cili nuk e ka paguar kontributin e tij deri në datën e regjistrimit të aktit të themelimit të shoqërisë komandite mban përgjegjësi ndaj shoqërisë komandite për të gjitha shpenzimet që ka bërë shoqëria komandite apo ortakët e saj të pakufizuar ose të kufizuar, duke përfshirë shpenzimet për shërbimet ligjore.

18.8 Kapitali themeltar i shoqërisë komandite përbëhet nga kontributet e ortakëve të pakufizuar dhe të kufizuar.

18.9 Ortakët e kufizuar detyrohen: (a) të japin kontributet në përputhje me marrëveshjen mbi bazën e së cilës është krijuar shoqëria komandite; dhe (b) të mos jenë aktivë në veprimtarinë e përditshme dhe në administrimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë komandite; dhe (c) të mos paraqiten para një pale të tretë si ortakë të pakufizuar ose që kanë autoritetin për të detyruar shoqërinë komandite. Ortakët e kufizuar që shkelin dispozitat e kësaj rregulloreje mund të bëhen përgjegjës për borxhet e shoqërisë komandite sikur të ishin ortakë të pakufizuar.

18.10 Ortakët e kufizuar nuk mund ta detyrojnë shoqërinë komandite. Asnjë kreditor nuk mund të mbështetet në përfaqësimin e ortakut të kufizuar për t'i krijuar përgjegjësi shoqërisë komandite. Nëse ortaku i kufizuar merret me veprime tregtare me qëllim të krijimit të detyrimit për shoqërinë komandite, kjo e fundit mund t'i miratojë këto veprime. Nëse shoqëria komandite nuk i miraton këto veprime, ortaku i kufizuar mban përgjegjësi personale ndaj kreditorit dhe kreditori nuk ka të drejtë të padisë shoqërinë komandite, përveç kur shoqëria komandite, me

dashje apo nga pakujdesia, i ka lënë të kuptojë një pale të tretë që ortaku i kufizuar ka qenë i autorizuar të detyrojë shoqërinë komandite.

18.11 Marrëveshja dhe statuti i shoqërisë komandite, si edhe të gjitha shenjat e shoqërisë, kokat e letrave dhe mënyrat e tjera në të cilat emri i shoqërisë komandite u paraqitet personave të tretë, duke përfshirë edhe ortakët e kufizuar që mund të duan të marrin pjesë në shoqëri më vonë, duhet të përfshijnë emrin e shoqërisë komandite, emrin e së paku një ortaku të pakufizuar, si dhe fjalët “shoqëri komandite”.

Neni 19

Administrimi i Shoqërisë Komandite

19.1 Shoqëria komandite administrohet vetëm prej ortakëve të pakufizuar. Ortakët e pakufizuar nuk mbajnë përgjegjësi ndaj ortakëve të kufizuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit nëse vendimi për të vepruar apo mosvepruar bazohet në të dhëna të arsyeshme dhe lidhet në mënyrë logjike me krijimin e fitimit të shoqërisë komandite.

19.2 Ortakët e kufizuar nuk mund të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë komandite. Ortaku i kufizuar nuk konsiderohet se “merr pjesë në administrim” vetëm nga fakti se është i punësuar apo ka lidhur një kontratë me shoqërinë, ose sepse është ndërmarrës i ndonjë veprimi për zbatimin apo mbrojtjen e të drejtave të ortakëve të kufizuar.

Neni 20

Kalimi i Interesave në Shoqëritë Komandite

20.1 Ortaku i kufizuar mund t'i kalojë interesat e tij në shoqërinë komandite vetëm me miratimin e të gjithë ortakëve të pakufizuar, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë. Kalimi i të drejtave në shoqërinë komandite përfshin edhe kalimin e të gjitha detyrimeve të ortakut të kufizuar në shoqërinë komandite.

20.2 Sipas urdhrorit të gjykatës apo organi tjetër të autorizuar me ligj, ortakët e pakufizuar të shoqërisë komandite duhet të mundësojnë kalimin e interesit të ortakut të kufizuar të shoqërisë komandite tek një person tjetër.

20.3 Pala e siguruar së cilës ortaku i kufizuar i ka dhënë mjet sigurimi mbi një interes të shoqërisë komandite mund të ushtrojë të gjithë të drejtat në fjalë të ortakut të kufizuar pasi të ketë njoftuar shoqërinë komandite.

20.4 Me vdekjen e ortakut të kufizuar, i cili është person fizik, interesi i tij i kufizuar në shoqërinë komandite i kalon trashëgimtarëve të tij, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë. Me shpërbërjen, falimentimin apo likuidimin e ortakut të kufizuar që është person juridik, kalimi i interesit të këtij ortaku të kufizuar bëhet në përputhje me dispozitat sipas të cilave u bë prishja, falimentimi apo likuidimi.

Neni 21

Ndarja e Fitimit dhe Humbjeve

Fitimi shpërndahet dhe humbjet mbulohen në mënyrë të barabartë midis ortakëve të kufizuar dhe të pakufizuar, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

Neni 22

Prishja dhe Falimentimi

22.1 Shoqëria komandite mund të vazhdojë të ekzistojë derisa shoqëria të ketë të paktën një ortak të pakufizuar dhe një ortak i kufizuar. Ortaku i kufizuar nuk ka të drejtë të shpërbëjë shoqërinë komandite, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

22.2 Në likuidimin e pasurisë së shoqërisë komandite, pasuria neto e shoqërisë duhet t'u shpërndahet në mënyrë të barabartë të gjithë ortakëve të kufizuar dhe të pakufizuar, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë komandite.

Kapitulli 5

Korporatat

Neni 23

Koncepti i Korporatave

23.1 Korporata është shoqëria tregtare kapitali themeltar i së cilës ndahet në një numër të caktuar aksionesh me të njëjtën vlerë nominale. Aksionerët e korporatës nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë.

23.2 Korporata është person juridik.

23.3 Korporata mund ta zotërojë pasurinë në emrin e vet. Pasuria e korporatës është e veçantë nga pasuria e themeluesve dhe aksionerëve të korporatës. Korporata përgjigjet për detyrimet e veta deri në kufirin e pasurisë së saj. Korporata nuk përgjigjet për detyrimet e themeluesve apo aksionerëve të saj. Aksionerët fillestarë të cilët nënshkruajnë aksionet për korporatën janë bashkarisht dhe individualisht përgjegjës për detyrimet e korporatës, në qoftë se nuk kanë derdhur kontributin e tyre në kapitalin themeltar të korporatës.

23.4 Aksionet e korporatës mund të përfaqësohen dhe evidentohen nga një dokument që i lëshohet aksionerëve, me regjistrimin në regjistrin e aksionerëve të shoqërisë, ose me anë të marrëveshjes ndërmjet aksionerëve në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

23.5 Një ose më shumë persona fizikë ose juridikë mund të themelojnë një korporatë dhe të zotërojnë aksionet e saj.

Neni 24

Shoqëritë Aksionere dhe Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar

24.1 Korporata mund të jetë shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas përcaktimit në statutin e saj dhe në emrin e shoqërisë.

24.2 Shoqëri aksionere quhet korporata, pronarët e së cilës mund t'i transferojnë aksionet e tyre pa miratimin e aksionerëve të tjerë ose të shoqërisë. Shoqëria aksionere mund të bëjë një ofertë publike për aksionet e saj sipas kushteve të parashikuara me ligj.

24.3 Shoqëria aksionere mund të ketë numër dhe kategori të ndryshme aksionerësh.

24.4 Shoqëria aksionere duhet të hartojë raportet dhe të bëjë publikime në përputhje me ligjin.

24.5 Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar quhet korporata, aksionet e së cilës shpërndahen vetëm ndërmjet themeluesve të saj ose ndërmjet personave të tjerë të përcaktuar paraprakisht.

24.6 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk duhet të bëjë ofertë publike për aksionet e saj dhe as t'ia ofrojë këto aksione në ndonjë mënyrë tjetër një numri të pakufizuar personash.

24.7 Numri i aksionerëve në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nuk duhet të jetë më i madh se pesëdhjetë. Nëse numri i aksionerëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e tejkalon këtë kufi, duhet që një mbledhje e përgjithshme e aksionerëve, brenda një viti nga data e tejkalimit, të marrë vendim për riorganizimin e shoqërisë si shoqëri aksionare, të bëjë ndryshimet përkatëse në dokumentat e themelimit të saj, si dhe t'i regjistrojë këto ndryshime. Me përfundimin e këtij afati, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e cila nuk ka vepruar kështu mund të likuidohet me procedurë gjyqësore me kërkesën e palëve të interesuara.

24.8 Aksioneri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, i cili dëshiron të shesë aksionet e tij, duhet t'ia ofrojë ato së pari aksionerëve të tjerë ose vetë shoqërisë dhe mund t'ia shesë aksionet e tij personave të tretë vetëm me pëlqimin e shoqërisë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në statutin apo rregulloret e shoqërisë.

Neni 25 Dokumentat e Themelimit

25.1 Marrëveshja e themeluesve të korporatës duhet të rradhitë llojet e aksioneve që emetohen nga shoqëria, shpërndarjen e këtyre aksioneve ndërmjet themeluesve dhe të drejtat dhe detyrimet e themeluesve që kanë të bëjnë me themelimin e korporatës. Marrëveshja e themeluesve për themelimin e korporatës quhet e lidhur që në momentin e nënshkrimit të saj dhe mbetet në fuqi deri në momentin e përmbushjes së detyrimeve nga themeluesit për dhënien e kontributeve në kapitalin themeltar.

25.2 Mbledhja themeluese miraton statutin e shoqërisë dhe ky miratim duhet të përfshihet në marrëveshjen e themeluesve. Akti themeltar i korporatës duhet të përmbajë:

- (a) emrin e korporatës;

- (b) llojin e korporatës nëse është shoqëri aksionere ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- (c) adresën e selisë së saj;
- (d) zyrat dhe degët përfaqësuese, nëse ka të tilla;
- (e) periudhën e kohëzgjatjes që mund të jetë për një kohë të pacaktuar;
- (f) qëllimin e korporatës që në përgjithësi mund të përshkruhet si “për çdo qëllim aktiviteti tregtar të ligjshëm”;
- (g) llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre;
- (h) kapitalin themeltar të korporatës, të shprehur në numrin e aksioneve të vlerës së përcaktuar nominale;
- (i) numrin e drejtorëve, emrat dhe adresat e bordit drejtues fillestar përveç në rastet e nenit 34.2;
- (j) emrat dhe adresat e themeluesve; dhe
- (k) procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

Statuti i shoqërisë mund të përmbajë edhe dispozita të tjera, të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë rregullore, si dhe dispozita që përcaktohen nga kjo rregullore.

25.3 Përveç marrëveshjes së themeluesve dhe statutit, themeluesit e korporatës mund të miratojnë rregulla të brendshme me të cilat përcaktohen në mënyrë më specifike marrëdhëniet ndërmjet aksionerëve, bordit drejtues, nëpunësve, si dhe rregullohen në mënyrë më të detajuar aktivitetet e korporatës. Rregullat e brendshme gjithashtu mund të përcaktojnë procedurat e mbledhjeve dhe procedurat lidhur me njoftimet. Bordi drejtues dhe nëpunësit duhet të veprojnë në përputhje me statutin dhe rregullat e brendshme.

25.4 Statuti dhe rregullat e brendshme të shoqërisë përbëjnë një kontratë mes shoqërisë, aksionerëve të saj dhe drejtorëve dhe kanë fuqi zbatuese si të tilla. Ndryshimet në statut, duhet të bëhen në bazë të kërkesave procedurale të kësaj rregulloreje si dhe duhet të marrin parasysh interesat e aksionerëve të pakicës.

25.5 Korporata konsiderohet e themeluar kur dokumentat themeluese pranohen për regjistrim nga agjensia që merret me regjistrimin e shoqërive tregtare.

Neni 26 Kapitali themeltar

26.1 Kapitalin themeltar të korporatës e përbën vlera e përgjithshme nominale e aksioneve të emetuara fillimisht nga shoqëria, ashtu siç është parashikuar në dokumentet e themelimit. Kapitali themeltar përfaqëson sasinë minimale të pasurisë e cila gjithmonë do të jetë e pranishme për përballimin e detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve. Kapitali themeltar krijohet nga

kontributet fillestare të aksionerëve, por nëse aksionet fillestare shiten mbi vlerën e tyre nominale, shoqëria mund të përftojë më shumë vlera monetare se kapitali themeltar.

26.2 Për shoqëritë aksionare kapitali themeltar duhet të jetë të paktën pesëdhjetë mijë marka gjermane (DM 5,000). Për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, ky kapital duhet të jetë të paktën pesë mijë marka gjermane (DM 5,000). Në secilin rast, kapitali themeltar mund të shprehet si ekuivalent në çdo valutë që është e ligjshme në Kosovë në kohën kur aksionerët investojnë kontributet e tyre fillestare. Për themelimin e bankave, institucioneve financiare dhe organizatave të sigurimit, që organizohen si korporata, ligje dhe rregullore të tjera mund të parashikojnë që kërkesat për minimumin e kapitalit themeltar të tyre të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara me këtë rregullore.

26.3 Pesëdhjetë për qind (50%) e kapitalit themeltar të korporatës duhet t'i paguhet korporatës nga aksionarët para regjistrimit të shoqërisë. Pjesa e papaguar e kapitalit themeltar e deklaruar në dokumentat e themelimit duhet të paguhet brenda një viti nga data e regjistrimit të shoqërisë. Nëse ndonjëri nga aksionerët nuk e ka derdhur kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë brenda vitit, dokumentet e themelimit të shoqërisë mund të parashikojnë që për këtë mospagesë të caktohet gjoja përkatëse.

26.4 Asnjë ofertë publike e aksioneve të shoqërisë aksionare nuk duhet të bëhet derisa kapitali themeltar të jetë paguar plotësisht. Asnjë aksioner nuk mund të lirohet nga detyrimi për pagesën e aksioneve, përveç me vendim të gjykatës.

Neni 27 Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

27.1 Me marrjen e vendimit të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, në përputhje me dispozitat e nenit 35, korporata mund ta zmadhojë kapitalin themeltar duke rritur vlerën nominale të aksioneve ose emetimin e aksioneve shtesë.

27.2 Kapitali themeltar i korporatës mund të zmadhohet vetëm pasi të jenë bërë të tëra pagesat e kontributeve ashtu siç është parashtruar në dokumentet e themelimit

27.3 Statuti i shoqërisë mund t'u japë të drejta përparësie aksionerëve për blerjen e aksioneve shtesë të emetuara nga korporata. E drejta e përparësisë mund t'ju jepet vetëm aksionerëve që kanë aksione me të drejtë vote.

27.4 Njoftimi për mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve në rendin e ditës të së cilës do të jetë çështja e zmadhimit të kapitalit themeltar, duhet të përmbajë këtë informacion:

(a) arsyet përse ky zmadhim është i nevojshëm; vlerën e propozuar të zmadhimit të kapitalit themeltar;

(b) projektin e ndryshimeve të statutit të shoqërisë lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar;

(c) shpjegimin për numrin e aksioneve shtesë që do të emetohen ose zmadhimin e vlerës nominale, sipas rastit;

(d) llogaritja e aksioneve të emetuara më parë si dhe të drejtat e aksionerëve në lidhje me aksionet shtesë që do të emetohen; si dhe

(e) datat e propozuara për fillimin dhe mbarimin e periudhës së regjistrimit për aksionet shtesë të emetuara.

Nëse ky njoftim nuk përmban informacionet e mësipërme, çdo vendim i mbledhjes së përgjithshme për zmadhimin e kapitalin themeltar mund të bëhet i pavlefshëm.

27.5 Nëse shoqëria emeton aksione shtesë apo ndryshon vlerën nominale të aksioneve, atëherë duhet menjëherë t'i pasqyrojë këto ndryshime në statutin saj.

27.6 Ligjet apo rregulloret që mbi bankat, organizatat financiare ose të sigurimit të cilat organizohen si korporata mund të parashikojnë procedura të tjera për zmadhimin e kapitalit të tyre, të ndryshme nga ato që parashikohen me këtë rregullore.

Neni 28

Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar të Shoqërisë

28.1 Nëse vlera e pasurisë neto të shoqërisë pas vitit të dytë apo vititeve vijuese financiare është më e vogël se kapitali themeltar fillestar, ajo duhet të njoftojë dhe të regjistrojë zvogëlimin përkatës të kapitalit të saj themeltar. Nëse vlera e pasurisë neto e përcaktuar si e tillë bë bazë të standarteve mbi kontabilitetin në fuqi, është më e vogël se minimumi i kërkesave të kapitalit themeltar të parashtruara në nenin 26.2 shoqëria likuidohet, përveçse kur mund të investohet kapital i ri i mjaftueshëm.

28.2 Korporata mund të bëjë zvogëlimin e kapitalit me vendim të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve. Shoqëria mund ta bëjë këtë duke zvogëluar vlerën nominale të aksioneve ose duke tërhequr një pjesë të aksioneve të saj të mbetura. Nëse sipas nenit 28.1 të kësaj rregulloreje shoqëria është e detyruar të shpallë zvogëlimin e kapitalit të saj themeltar dhe nëse, pavarësisht nga ky detyrim, mbledhja e përgjithshme e aksionerëve nuk vendos të zvogëlojë kapitalin themeltar apo në një mënyrë tjetër nuk përmbush kërkesat për minimumit e kapitalit themeltar, konsiderohet se mbledhja ka pranuar paaftësinë paguese të shoqërisë dhe ka vendosur të bëjë likuidimin e saj. Nëse ndodh kjo, gjykata mbi bazën e kërkesës të ndonjë kreditori mund të shpallë shoqërinë si të falimentuar dhe të zbatojë ndaj saj procedurat e falimentimit.

28.3 Vendimi për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare do të merret në pajtim me të njëjtën procedurë që ndiqet për zmadhimin e kapitalit themeltar.

28.4 Me skasimin e afatit tremujor (3) që nga data e publikimit të vendimit të shoqërisë për zvogëlimin e kapitalin të saj themeltar, aksionet që u tërhoqën po nuk iu dorëzuan shoqërisë bëhen të pavlefshme.

Neni 29

Themeluesit e Korporatës

29.1 Themeluesit e korporatës janë personat që marrin përsipër të themelojnë korporatën. Këta themelues bëjnë një marrëveshje me shkrim me të cilën përcaktohet procedura për themelimin e korporatës dhe parashtrihen përgjegjësitë e themeluesve ndaj atyre personave të cilët kanë nënshkruar për aksionet fillestare të shoqërisë si dhe përgjegjësitë e themeluesve ndaj të tretëve para ekzistimit të shoqërisë. Pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të tillë, çdo person që vepron si themelues e pranon përgjegjësinë e tij ndaj nënshkruesve të tillë të aksioneve si dhe ndaj personave të tretë.

29.2 Themeluesit duhet të veprojnë në mirëbesim dhe të kenë parasysh interesin më të mirë të korporatës gjatë procesit të themelimit të saj.

29.3 Themeluesit e korporatës mbajnë përgjegjësi kolektive dhe individuale përsa i përket detyrimeve që kanë të bëjnë me themelimin e korporatës si dhe që dalin para regjistrimit të saj. Korporata përgjigjet për detyrimet e themeluesve që kanë të bëjnë me themelimin e saj, vetëm në rastet e miratimit të mëvonshëm të veprimeve të tyre nga mbledhja e përgjithshme e aksionerëve.

29.4 Asnjë themelues që është njëkohësisht dhe aksioner nuk mund të gëzojë të drejta dhe privilegje si aksioner, të cilat nuk u janë dhënë aksionerëve të tjerë të së njëjtës kategori.

29.5 Pas regjistrimit të korporatës themeluesit si të tillë, nuk kanë asnjë rol tjetër në administrimin e shoqërisë. Asnjë korporatë nuk mund të krijojë ndonjë “mbledhje të themeluesve” apo ndonjë “bord të themeluesve,” ose diçka të ngjashme, por çdo themelues që është person fizik mund të shërbejë si anëtar i bordit drejtues ose si nëpunës i shoqërisë dhe çdo themelues mund të zotërojë shumicë aksionesh.

Neni 30

Të Drejtat dhe Detyrimet në Lidhje me Aksionet

30.1 Shoqëria mund të emetojë aksione vetëm në formë të regjistruar.

30.2 E drejta e aksionerëve për lënien peng të aksioneve të shoqërisë nuk mund të kufizohet ose të ndalohet nga shoqëria. Aksioneri gëzon të drejtën e votimit të aksioneve të lëna peng, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e pengut.

30.3 Shoqëria mund të marrë peng aksionet e saj vetëm në qoftë se:

- (a) aksionet e lëna peng janë shlyer plotësisht;
- (b) numri total i aksioneve të vetë shoqërisë të lëna peng shoqërisë nuk përfaqëson më shumë se dhjetë (10%) për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë; si dhe
- (c) marrëveshja e pengut miratohet nga bordi drejtues.

30.4 Korporata nuk mund të vërë peng aksionet e veta të paemetuara.

30.5 Statuti i korporatës mund të parashikojë emetimin e kategorive të ndryshme të aksioneve dhe mund të përcaktojë të drejtat e secilës kategori të aksioneve në lidhje me votimin, dividendet, shpërndarjen e pasurisë me shpërbërjen e shoqërisë apo çështje të tjera.

30.6 Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të vendosë kufizime mbi numrin e aksioneve, vlerën totale nominale të aksioneve apo numrin maksimal të votave që mund të ketë një aksioner.

Neni 31 Regjistri i Aksionerëve

31.1 Shoqëria duhet të krijojë dhe të mbajë një regjistër të aksionerëve jo më vonë se një muaj pas regjistrimit të saj. Statuti i shoqërisë duhet të përcaktojë vendin se ku do të mbahet regjistri i aksionerëve.

31.2 Të gjitha kalimet e aksioneve do të regjistrohen në regjistrin e aksionerëve. Në regjistër çdo aksioni duhet t'i korrespondojë një numër rendor. Për çdo numër rendor duhet të regjistrohet emri i aksionerit dhe data e blerjes së aksionit prej tij. Regjistri duhet të përmbajë edhe emrin dhe adresën e aksionerëve që janë persona juridikë ashtu siç janë regjistruar, dhe emri dhe vendi i rezidencës të aksionerëve që janë persona fizikë. Të dhënat që ka shoqëria për ata që kanë njoftuar shoqërinë se kanë të drejta të siguruara në aksione duhet të përfshihen në regjistrin e aksionerëve, ku duhet të thuhet nëse ata kanë të drejtën e votës për këto aksione. Regjistri i aksionerëve duhet të përmbajë gjithashtu edhe numrin e aksioneve në pronësi të secilit aksioner. Regjistri i aksionerëve mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera.

31.3 Shoqëria mund të ngarkojë një bankë, depozit marrës, apo çfarëdo agjent tjetër të autorizuar me ligj, të mbajë regjistrin e aksioneve.

31.4 Shoqëria duhet të mbajë regjistrin e aksionerëve në selinë e saj kryesore në Kosovë, ose në selinë kryesore në Kosovë të agjentit të angazhuar për mbajtjen e regjistrit dhe duhet të lejojë aksionerët, pengmarrësit e aksioneve, apo të aksionerëve të emëruar të shohin regjistrin e aksionerëve.

31.5 Me kërkesën e parë të cilitdo aksioner, të cilitdo përfaqësuesi të autorizuar të cilitdo aksioneri, apo të cilitdo personi ose enti që ka interesa të siguruara në aksionet e shoqërisë, mbajtësi i regjistrit të aksioneve duhet të japë të dhëna nga regjistri.

31.6 Regjistrimi i të dhënave në regjistër duhet bërë jo më vonë se tre (3) ditë nga data kur transferuesi ose marrësi i aksionit apo i ndonjë interesi mbi të i dorëzon sekretarit të shoqërisë apo agjentit të angazhuar nga shoqëria për mbajtjen e regjistrit të aksionerëve ose (a) certifikatat e aksioneve që mbajnë nënshkrimin e transferuesit dhe të dhënat që transferuesi i ka transferuar marrësit aksionet në fjalë; ose (b) në rastin e aksioneve të paçertifikuara, një deklaratë të bërë nga transferuesi ku ai shpreh se i ka transferuar marrësit interesin e tij në aksionet e paçertifikuara.

31.7 Nëse sekretari apo agjenti i shoqërisë nuk regjistron apo refuzon të regjistrojë një të dhënë në regjistrin e aksionerëve, brenda pesë ditëve nga data e kërkesës duhet t'i dërgojë personit që kërkoj regjistrimin shpjegimin për refuzimin e këtij regjistrimi.

31.8 Personi që është i pakënaqur nga refuzimi për regjistrimin e të dhënave në regjistrin e aksionerëve mund të bëjë një kërkesë në gjykatën përkatëse. Nëse gjykata vendos që regjistrimi duhet të ishte bërë, nëpunësi apo agjenti duhet të bëjë menjëherë regjistrimin. Nëse refuzimi fillestar për të bërë regjistrimin shkaktoi mospërfshirjen e personit në shpërndarjen e dividendeve, shoqëria duhet t'i japë dividendin këtij personit. Nëse refuzimi fillestar shkaktoi mosparaqitjen e personit në mbledhjen e aksionerëve, në rrethana të përshtatshme gjykata mund të urdhërojë shoqërinë të zhvillojë përsëri mbledhjen. Megjithatë, nga mënyrat e mësipërme nuk mund të përfitojnë palët që i paraqitën sekretarit apo agjentit një çertifikatë të aksionit që përmbante: (a) nënshkrim të transferuesit që nuk është krejt identik me atë që paraqitet në regjistër; ose (b) një nënshkrim i bërë në gjuhë jo të qartë për transfertën.

Neni 32 Të Drejtat dhe Detyrimet e Aksionerëve

32.1 Të drejtat e aksionerëve janë:

- (a) të marrë si dividend një pjesë të tepricës (të përkufizuar në Nenin 38.1) të fituar nga shoqëria, nëse mbledhja e përgjithshme e aksionerëve e deklaroi dividendin dhe nëse shoqëria lejohet të paguajë e në të vërtetë e paguan dividendin;
- (b) të marrë shpërndarje proporcionale *pro-rata* të pasurisë neto të shoqërisë kur ajo likuidohet sipas ligjeve dhe rregulloreve mbi falimentimin, pengun dhe paaftësinë për të paguar;
- (c) të marrë aksione falas me zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionere, në mënyrë që zmadhimi i kapitalit themeltar të mos zvogëlojë vlerën e interesave të tyre në shoqëri;
- (d) të drejtën e parablerjes së aksioneve të emetuara nga shoqëria, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti i saj;
- (e) të lërë trashëgim të gjitha aksionet apo një pjesë të tyre personave fizikë dhe juridikë, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar;
- (f) tu shesë apo në një mënyrë tjetër tu transferojë aksionet personave fizikë dhe juridikë, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar;
- (g) të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme të aksionerëve dhe të votojë në mënyrë të rregullt për çështjet që shtrohen në këto mbledhje, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti për sa i përket kategorive të veçanta të aksioneve;
- (h) të marrë të gjithë informacionin publik të nxjerrë nga shoqëria në lidhje me veprimtarinë e saj duke përfshirë të drejtën e marrjes së dëftësive financiare dhe dokumentave të tjera siç parashikohet në këtë rregullore dhe në statutin e shoqërisë.

32.2 Statuti i shoqërisë mund të vendosë kufizime për sa i përket numrit të aksioneve që mund të zotërojë një aksioner, vlerës nominale totale të tyre, si dhe numrit maksimal të votave që mund të ketë aksioneri.

32.3 Statuti i shoqërisë mund të parashikojë edhe të drejta të tjera për aksionerët që nuk janë renditur këtu.

32.4 Aksionet e të njëjtës kategori kanë të drejta të njëjta.

32.5 Aksionerët duhet të paguajnë për aksionet në bazë të marrëveshjes në fuqi për nënshkrimin e aksioneve, kësaj rregulloreje apo dokumentave të themelimit të shoqërisë.

32.6 Gjykatat kompetente janë të autorizuar të zgjidhin konfliktet midis aksionerëve, midis aksionerëve dhe shoqërisë, midis aksionerëve dhe nëpunësve e drejtuesve të shoqërisë. Megjithatë nëse parashikohet në statut, dokument tjetër themelues ose në marrëveshjen për nënshkrimin e aksioneve, këto mosmarrëveshje do të zgjidhen me anë të arbitrazhit privat apo metodave të tjera alternative për zgjidhjen e konflikteve.

Neni 33

Mbledhja për Themelimin e Shoqërisë

33.1 Mbledhja e themelimit është hap themelor për formimin e shoqërisë. Mbledhja e themelimit konsiderohet të jetë kryer nëse të gjithë themeluesit e përcaktuar në marrëveshjen e themelimit janë të pranishëm personalisht apo të përfaqësuar nga një përfaqësues. Kryetari i mbledhjes do të zgjidhet nga shumica e themeluesve.

33.2 Mbledhja e themelimit duhet të vendosë unanimisht për krijimin e shoqërisë si dhe duhet të miratojë unanimisht statutin.

33.3 Mbledhja e themelimit duhet gjithashtu që me anë të shumicës së thjeshtë:

- (a) të zgjedhë nëpunësit e shoqërisë sipas statutit;
- (b) të zgjedhë anëtarët e bordit fillestar drejtues;
- (c) të miratojë vlerësimin e kontributeve në natyrë; si dhe
- (d) të miratojë kapitalin themeltar fillestar.

Neni 34
Administrimi i Korporatës

34.1 Shoqëritë aksionere duhet të ndajnë funksionet e administrimit ndërmjet mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, bordit drejtues dhe nëpunësve të shoqërisë.

34.2 Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me më pak se njëzet (20) aksionerë mund të parashikojë për administrimin e shoqërisë pa bord drejtues. Në këtë rast mbledhja e përgjithshme e aksionerëve do të ushtrojë edhe funksionet e bordit drejtues.

Neni 35
Mbledhja e Përgjithshme e Aksionerëve

35.1 Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve përbëhet nga të gjithë aksionerët që janë regjistruar si të tillë në regjistrin e shoqërisë tridhjet ditë (30) para datës kur është caktuar kjo mbledhje. Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve është organi më i lartë drejtues i shoqërisë, por kompetencat e saj janë të kufizuara për votimin mbi çështjet e parashtruara në këtë nen.

35.2 Mbi çështjet e mëposhtme vendos vetëm mbledhja e përgjithshme e aksionerëve:

- (a) ndryshimet e statutit;
- (b) nëse do zmadhohet apo zvogëlohet kapitali themeltar i shoqërisë;
- (c) konsolidimi i aksioneve të emetuara dhe të pashlyera;
- (d) nëse të “ndahen” aksionet e emetuara ose të pashlyera apo të emetohen aksionet shtesë;
- (e) cilët duhet të jenë anëtarët e bordit drejtues;
- (f) nëse duhen krijuar apo ndryshuar rregulloret;
- (g) nëse shoqëria duhet të likuidohet dhe cila duhet të jetë përbërja e këshillit të likuidimit;
- (h) nëse shoqëria duhet të kërkojë mbrojtjen e ligjeve të falimentimit apo paaftësisë paguese; si dhe
- (i) cili duhet të shërbejë si ekspert kontabël i jashtëm i shoqërisë.

35.3 Vendimet që kanë të bëjnë me çështjet e përmendura në paragrafet (e), (f), dhe (i) të nenit 35.2 mund të merren me votë të shumicës së thjeshtë të aksioneve të përfaqësuara në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve. Ndryshimet e statutit (nënparagrafi (a) të nenit 35.2 kërkojnë votën pro të shumicës së të gjitha aksioneve të emetuara dhe shtesë. Në rastet kur ndryshimi i propozuar i statutit është i pafavorshëm ndaj një kategorie të veçantë aksionesh, vendimi për ndryshimin kërkon votimin në favor të shumicës së kategorisë në fjalë. Vendimet lidhur me çështjet e përmendura në të gjitha nënparagrafet e tjera të nenit 35.2 mund të merren vetëm prej shumicës me dy të tretat të aksioneve të paraqitura në mbledhje.

35.4 Vendimet në lidhje me çështjet që kjo rregullore apo statuti i shoqërisë ka rezervuar ekskluzivisht për mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve nuk mund t'i delegohen bordit drejtues apo nëpunësve të shoqërisë.

35.5 Edhe nëse nuk ka pasur pajtim me kërkesat e njoftimit për mbledhje të përgjithshme, shoqëria mund të veprojë me pëlqimin unanimit të aksionerëve të saj të shprehur në dokumentin që përmban të tëra nënshkrimet e të gjithë aksionerëve.

35.6 Shoqëria aksionere duhet të mbajë një mbledhje të përgjithshme të aksionerëve, brenda nëntëdhjet ditëve nga mbyllja e vitit fiskal të shoqërisë.

35.7 Të gjitha mbledhjet e aksionerëve përveç mbledhjes së përgjithshme vjetore janë mbledhje të jashtëzakonshme. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga nëpunësit e shoqërisë, nga shumica e anëtarëve të bordit drejtues, ose nga aksionerët që zotërojnë jo më pak se njëzet për qind (20%) të aksioneve me të drejtë vote të emetuara dhe të pashlyera të shoqërisë.

35.8 Të paktën tridhjet ditë (30) para mbledhjes së përgjithshme ose të jashtëzakonshme, shoqëria duhet të njoftojë secilin aksioner në adresën e përcaktuar në regjistrin e aksionerëve. Njoftimi duhet të përmbajë kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes. Për çdo mbledhje të përgjithshme të aksionerëve, rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje të përmendura në nenin 35.2 për të cilat është menduar. Për çdo mbledhje të jashtëzakonshme, propozuesi i mbledhjes duhet të shkruajë dhe të përfshijë rendin e ditës në njoftim.

35.9 Njoftimi duhet t'u dërgohet të gjithë aksionerëve të zakonshëm që kanë dhënë të gjitha kontributet për aksionet, secilit nëpunës të shoqërisë, secilit anëtar të bordit drejtues dhe aksionerëve të preferuar që kanë të drejtën e votës. Krahas këtij njoftimi, shoqëria aksionare duhet të nxjerrë edhe njoftim publik. Shoqëria do të konsiderohet që e ka bërë këtë nëse jo më pak se njëzetën ditë (21) para datës së caktuar për mbledhjen, ka publikuar në një gazetë me qarkullim të përgjithshëm në Prishtinë, Kosovë, në shqip, serbisht dhe anglisht njoftimin për kohën, vendin dhe rendin e ditës. Ky njoftim nuk duhet të jetë më i vogël në dukje se dhjet (10%) për qind e fletës së shtypur.

35.10 Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve nuk mund të marrë vendime në lidhje me çështje që nuk ishin përfshirë në rendin e ditës, përveç kur vendimet e tilla janë marrë në mbledhjen në të cilën janë të pranishëm aksionerët e regjistruar që përfaqësonin të gjitha aksionet e shoqërisë të autorizuar të votojë. Të gjitha vendimet e marra në mbledhjen e tillë do të kenë fuqi dhe efekt ligjor edhe nëse njoftimi nuk është bërë si duhet. Mbledhja e aksionerëve mund të mbahet në çfarëdo vendi në Kosovë apo në ndonjë vend tjetër që përcaktohet në statutin e shoqërisë.

35.11 Mbledhja e aksionerëve nuk mund të ndërmarrë asnjë veprimtari tregtare në qoftë se një shumicë nuk është e pranishme personalisht apo me prokurë. Shumica quhet se është e pranishme nëse aksionerët apo përfaqësuesit e autorizuar që përfaqësojnë të paktën tridhjetetë për qind (33%) të aksioneve votuese të shoqërisë, janë të regjistruar si të pranishëm, përveç kur parashikohet ndryshe në statuti i shoqërisë. Për t'u regjistruar si i pranishëm secili aksioner apo përfaqësues i tij i autorizuar duhet të tregojë dhe shoqëria duhet të verifikojë, se aksioneri është regjistruar në mënyrën e duhur në regjistrin e aksionerëve të paktën tridhjet ditë (30) para

lajmërimit të ditës së mbledhjes. Mbledhja do të shtyhet në qoftë se shumica e mjafueshme nuk paraqitet brenda një kohe të arsyeshme nga koha e parashikuar.

35.12 Nëse shumica nuk është e pranishme, duhet që shoqëria brenda një muaji nga data e thirrjes së mbledhjes ku shumica nuk është e pranishme të thërrasë dhe të dërgojë njoftimet për një mbledhje tjetër të aksionerëve. Për këtë mbledhje, shumica duhet të përbëjë njëzetepesë për qind (25%) të totalit të aksioneve votuese të shoqërisë.

35.13 Në mbledhjen e aksionerëve, një aksioner ka të drejtën e një vote për secilin aksion që ai zotëron ose përfaqëson në bazë të prokurës apo mënyre tjetër. Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund ta ndryshojë këtë kërkesë, por votat e asnjërit prej aksionerëve nuk mund të zvogëlohen pa pëlqimin e tij.

35.14 Secili aksioner emri i të cilit paraqitet në regjistrin e aksionerëve tridhjet ditë para datës kur është thirrur mbledhja e aksionerëve mund të marrë pjesë në një mbledhje të tillë personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi të rregullt të autorizuar.

Neni 36 Bordi Drejtues

36.1 Përveç kur parashikohet ndryshe nga neni 34.2, çdo shoqëri duhet të emërojë dhe të mbajë një bord drejtues. Bordi drejtues është përgjegjës për veprimtarinë e shoqërisë. Përveç kur parashikohet ndryshe në statut, rregullat e brendshme apo nenin 35.2, bordi drejtues ka kompetencat ekskluzive që:

- (a) të punësojë dhe shkarkojë nga puna nëpunësit e shoqërisë;
- (b) të autorizojë të gjitha marrëveshjet dhe angazhimet e shoqërisë;
- (c) të mundësojë që shoqëria të blejë aksionet e veta;
- (d) të mundësojë që shoqëria të marrë borxh të konsiderueshëm nëpërmjet huave

ose nxjerrjes së obligacioneve dhe instrumenteve të tjera të konvertueshme të borxhit.

- (e) të përcaktojë kompensimin e nëpunësve të shoqërisë;
- (f) të përcaktojë mënyrat e administrimit të çdo teprice;
- (g) të mbikqyrë respektimin e ligjit në fuqi në lidhje me standartet e llogarive nga shoqëria;
- (h) në rastin e shoqërisë aksionere:

(i) të sigurohet që një kontroll financiar mbi librat e llogarive dhe të dhënave të shoqërisë zhvillohet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i pavarur dhe raporti t'i drejtohet mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve dhe secili drejtor dhe nëpunës të ketë mundësinë e shikimit të këtij raporti; si dhe

(ii) të sigurohet përgatitja e pavarur e një raporti vjetor, i cili përmban një deklaratë të kontrollit financiar për gjendjen financiare të shoqërisë, një raport nga nëpunësit në lidhje me gjendjen e veprimtarive, dhe të dhëna të tjera që mund të kërkohet nga statuti,

rregulloret apo ligji. Raporti duhet të nënshkruhet nga kryetari i bordit dhe të paktën një drejtor tjetër dhe t'iu shpërndahet drejtorëve, nëpunësve dhe aksionerëve.

36.2 Vetëm një person fizik mund të jetë anëtar i bordit drejtues. Edhe pse nëpunësit apo aksionerët mund të jenë drejtorë, por statuti nuk mund ta kufizojë të drejtën për tu bërë anëtar i bordit drejtues vetëm për nëpunësit apo aksionerët e shoqërisë. Anëtarët e bordit drejtues, individualisht, nuk mund të detyrojnë shoqërinë ndaj personave të tretë, por shoqëria mund t'i miratojë më vonë veprimet juridike cilitdo anëtar i bordit drejtues nëse ky veprim është brenda kompetencave të shoqërisë.

36.3 Shoqëria mund të mbajë vetëm një bord drejtues dhe as dokumentet e themelimit, as mbledhja e përgjithshme e aksionerëve nuk mund të krijojnë organe të tjera, përveç mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, që të jenë më të larta se bordi drejtues. Kompetencat që i rezervohen bordit drejtues nuk mund t'i jepen mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve apo nëpunësve, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti apo nga rregullat e brendshme. Bordi drejtues mund të krijojë nënkomisione këshilldhënëse për ta ndihmuar atë, por këto komisione nuk mund të kenë apo të ushtrojnë asnjë nga kompetencat e bordit drejtues.

36.4 Numri i drejtorëve përcaktohet nga statuti. Shoqëria aksionare nuk mund të ketë më pak se tre (3) drejtorë.

36.5 Dispozitat për mbledhjet e bordit drejtues dhe për mbushjen e vendeve të zbrazëta në këtë bord që ndodhin në kohën mes mbledhjeve të përgjithshme të aksionerëve duhet të parashtrohen në statut apo në rregullat e tjera brendshme.

36.6 Statuti apo rregullat e tjera të brendshme duhet të parashikojnë kushtet në bazë të të cilave një drejtor mund të japë dorëheqjen dhe bazat mbi të cilat një drejtor mund të shkarkohet apo të ndërrohet.

36.7 Një drejtor ka detyrim për mirëbesim ndaj shoqërisë; kjo mund të rregullohet me ligj. Ky detyrim përfshin detyrimin për të vepruar në mirëbesim dhe në përfitim të gjithë shoqërisë; detyrimin që të ushtrojë kompetencat vetëm për qëllimet e duhura; detyrimin për të shqyrtuar në mënyrën e duhur çështjet për të cilat do të merret një vendim; detyrimin për të shmangur konfliktet aktuale ose potenciale të interesave të tij personale dhe atyre të shoqërisë; dhe detyrimin për të ushtruar kujdes dhe aftësi në përmbushjen e funksioneve të tij.

36.8 Asnjë drejtor nuk mund të mbajë përgjegjësi për ndonjë veprim apo mosveprim, në qoftë se veprimi apo mosveprimi kryhet në mirëbesim, dhe është i bazuar në informacion dhe analiza të arsyeshme racionalisht të lidhura me qëllimet e shoqërisë.

Neni 37 Nëpunësit

37.1 Nëpunësit e një korporate emërohen nga bordi drejtues. Korporata mund të ketë aq nëpunës sa parashikohen në statut, por jo më pak se dy (2). Në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, një person fizik mund të kryejë më shumë se një funksion.

37.2 Detyrat e secilit nëpunës parashtrohen në statut, rregulloret apo udhëzime e veçanta të bordit drejtues, me kusht që megjithatë çdo korporatë të emërojë një sekretar detyrat e të cilit përfshijnë në mënyrë specifike, përvec të tjerave, detyrën për mbajtjen e regjistrit të aksionerëve, të bëjë njoftimet e nevojshme, të mbajë procesverbalet e nevojshme dhe të dhëna të tjera, dhe të sigurojë zhvillimin si duhet të mbledhjeve të përgjithshme të aksionerëve dhe të mbledhjeve të bordit drejtues, si dhe të veprojë si përfaqësues i shoqërisë për marrjen e njoftimeve.

37.3 Të gjithë nëpunësit e shoqërisë kanë të njëjtat detyrime si edhe anëtarët e bordit drejtues.

37.4 Asnjë nëpunës nuk ngarkohet me përgjegjësi për veprime ose mosveprime, nëse ato kryhen në mirëbesim, të bazuar në informacion dhe analiza të arsyeshme racionalisht të lidhura me qëllimet e shoqërisë.

37.5 Nëpunësit e korporatës mund të hyjnë në marrëveshje me personat e tretë në emër të kompanisë nëse (a) marrëdhënia e shoqërisë me një kreditor të tillë lind në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit të shoqërisë; (b) marrëdhënia e nëpunësit të shoqërisë me palën e tretë kreditore nuk ka të bëjë me marrëdhënie personale; dhe (c) veprimi individual kryhet në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së shoqërisë.

37.6 Nëpunësi i korporatës duhet t'i paraqesë bordit drejtues çdo interes financiar që ai mund të ketë: (a) me konkurrentët e shoqërisë; (b) kreditorët kryesorë të shoqërisë; (c) furnizuesit kryesorë të shoqërisë me mallra ose shërbime; ose (d) klientet kryesorë të shoqërisë. Në këtë nen, "interes financiar" i një nëpunësi do të thotë çdo lidhje, duke përfshirë pa kufizim çdo lidhje pronësie, që ka nëpunësi ose çdo anëtar i rrethit të tij të ngushtë familjar me ndonjë nga konkurrentet, kreditorët, furnizuesit, ose klientët e sipërpërmendur, që mund të shkaktojnë favorizime të ndonjërit prej tyre nga ana e nëpunësit në marrëdhëniet me shoqërinë.

37.7 Nëpunësi duhet të japë informacionin e kërkuar në nenin 37.6 në kohën kur merret në punë nga shoqëria, ose në kohën kur lind interesi financiar. Nëse nëpunësi nuk informon sipas rregullit, mund të mbajë përgjegjësi personalisht përpara shoqërisë deri në masën e dëmeve aktuale që shoqëria pëson si rezultat i mosinformimit.

37.8 Nëpunësit e shoqërisë duhet të mos marrin pjesë në veprimtari që konkurojnë në mënyrë direkte me veprimtarinë tregtare të shoqërisë, përvec kur parashikohet ndryshe nga statuti, rregullat e brendshme apo kontrata e punësimit. Nëpunësi që konkuron me veprimtarinë tregtare të shoqërisë mund të mbajë përgjegjësi personalisht për dëmet që i shkaktohen shoqërisë nga kjo.

37.9 Çdo nëpunës i shoqërisë mund të mbajë njëkohësisht më shumë se një pozicion në shoqëri, përvec kur parashikohet ndryshe në statut apo rregullat e brendshme të shoqërisë. Megjithatë, në shoqërinë aksionere, asnjë person nuk mund të ketë njëkohësisht funksionin e nëpunësit më të lartë të shoqërisë dhe atë të mbikëqyrës së financave të shoqërisë.

37.10 Statuti, rregullat e brendshme ose bordi drejtues mund t'iu ngarkojnë nëpunësve çdo detyrë që lidhet me shoqërinë, por detyrat e drejtorëve që parashikohen në nenin 36.1 nuk mund të delegohen.

Neni 38
Shpërndarja e Fitimeve të Korporatës

38.1 Llogaritja e fitimit dhe e humbjes me qëllim bërjen e deklaratave financiare duhet bërë në bazë të rregulloreve mbi standartet e kontabilitetit, në fuqi. Nëse shoqëria realizon fitim sipas rregullave dhe rregulloreve që parashikojnë shpërndarjen e dividendit, çdo tepricë pas pagesës së taksave të saj (“Teprica”) mbetet pronë e shoqërisë dhe shoqëria mund ta përdorë atë sipas përcaktimit nga bordi drejtues.

38.2 Bordi drejtues mund të shpallë shpërndarjen e tepricës aksionerëve, në mënyrë të barabartë për çdo aksion që bën pjesë në një kategori të caktuar (“dividenti”).

38.3 Edhe në qoftë se bordi drejtues deklaron dividend, shoqëria duhet të shlyejë dividendin vetëm nëse:

- (a) statuti i saj e lejon këtë shprehimisht;
- (b) shoqëria ka aftësi paguese edhe pas shlyerjes së dividendit;
- (c) i tërë dividendi mund të paguhet nga teprica;
- (d) kapitali themeltar është shlyer plotësisht; si dhe
- (e) shlyerja e dividendit nuk do të zvogëlojë kapitalin themeltar.

Në këtë nen me “aftësi paguese” nënkuptohet mundësia për shlyerjen e plotë të borxheve kur ata bëhen të detyrueshme për t’u paguar dhe pasja e një teprice në fletën e bilancit të kontrollit të fundit financiar. “Paaftësia paguese” nënkupton të kundërtën e aftësisë paguese. Për këtë arsye, për shlyerjen e dividendit shoqëria duhet të kalojë me sukses të dy testet, atë të rrjedhshmërisë së parave dhe testin asetëve. Nëse shoqëria ka aftësi paguese dhe nëse shlyerja e dividendit do të sjellë gjendje të paaftësisë paguese, duhet të përcaktohet në përputhje me standartet llogaritare në fuqi.

38.4 Për çdo shlyerje të dividendeve në kundërshtim me dispozitat e nenit 38.3 vlerat monetare duhet të kthehen nga secili aksioner që e mori aktualisht dividendin.

38.5 Bordi drejtues mund të shpallë dividend të çfarëdo sasive të ligjshme, përveç kur parashihet ndryshe në statutin apo rregullat e brendshme të shoqërisë.

38.6 Dividentet mund të paguhen vetëm në valutë që është e ligjshme në Kosovë.

38.7 Aksionerët që janë regjistruar në regjistrin e aksionerëve të paktën tridhjetë ditë (30) para mbledhjes së bordit drejtues në të cilën është shpallur dividendi, quhen “aksionerë dividendi të regjistruar” dhe si të tillë janë të autorizuar të marrin këtë dividend.

Neni 39 Likuidimi i Korporatës

39.1 Korporata e krijuar sipas kësaj rregulloreje mund të likuidohet dhe punët e saj mund të mbyllën (“likuidimi”) me anë të:

- (a) votimit në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve;
- (b) përfundimit të periudhës për të cilën ishte formuar apo për arsye të tjera të parashtruara shprehimisht në statutin apo në rregullat e brendshme të shoqërisë; ose
- (c) vendimit të gjykatës;
- (d) aplikimit të ligjeve apo rregulloreve për falimentimin.

Kjo rregullore duhet të zbatohet nëse likuidimi ndodh në bazë të nënparagrafeve (a) ose (b) (“likuidimi vullnetar”). Në qoftë se likuidimi bëhet sipas nënparagrafeve (c) ose (d) (“likuidim jo-vullnetar”) do të zbatohen ligjet e falimentimit dhe ligje të tjera.

39.2 Në likuidimin në mënyrë vullnetare, mbledhja e përgjithshme e aksionerëve duhet të emërojë këshilli e likuidimit (“këshilli”) të cilit do t’i jepen të gjitha kompetencat e administrimit të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, bordit drejtues dhe nëpunësve të shoqërisë.

39.3 Menjëherë pas formimit të tij, këshilli i likuidimit duhet të depozitojë njoftimin për likuidimin vullnetar në agjensinë që bën regjistrimin e shoqërive tregtare. Nëse ky njoftim nuk është depozituar dhe nuk është shpallur publikisht për të paktën tridhjetë ditë (30) para kryerjes së ndonjë shitjeje të pasurisë nga këshilli siç parashikohet në këtë rregullore, shitja mund të deklarohet e pavlefshme nga gjykata në bazë të kërkesës së ndonjë kreditori të pashlyer. Njoftimi duhet të përmbajë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, që mbledhja e përgjithshme e aksionerëve ka vendosur të likuidojë pasuritë e shoqërisë dhe të mbyllë punët e saj; datën e këtij vendimi; vendin se ku duhet të depozitohen pretendimet e kreditorëve; dhe deklaratën se shitja e pasurive të shoqërisë në dobi të kreditorëve nuk mund të bëhet më shpejt se tridhjetë ditë (30) pas datës së këtij njoftimi.

39.4 Këshilli duhet t’i dërgojë njoftim me shkrim të gjithë kreditorëve të njohur të shoqërisë dhe të lejojë palët e siguruar që të marrin pasuritë të cilat janë mjet sigurimi. Nëse shoqëria zotëron pasuri ku kreditorët kanë një interes të siguruar këshilli duhet t’ia japë pasurinë palës së siguruar. Pala e siguruar duhet të shesë apo në një mënyrë tjetër ta disponojë pasurinë në përputhje me ligjet në fuqi për transaksionet e siguruar. Nëse shitja apo mënyra tjetër e disponimit sjell të ardhura më të mëdha nga sa shoqëria i detyrohet palës së siguruar, pala e siguruar duhet t’ia dërgojë këtë teprice këshillit.

39.5 Brenda tridhjetë ditëve (30) nga krijimi i tij, këshilli i likuidimit duhet t’i ketë kontrolluar librat e llogarisë dhe dokumentet e shoqërisë aksionere dhe të ketë përpiluar inventar të pronave të saj dhe listën e borxheve të saj. Gjithashtu këshilli duhet të përcaktojë një mënyrë të arsyeshme nga ana tregtare për shitjen e pasurive të shoqërisë, kohën dhe vendin e shitjes. Shitja mund të jetë publike ose private dhe mund të bëhet në çdo mënyrë të arsyshme nga ana tregtare.

Shoqëria duhet të ofrojë mundësinë për inspektimin e inventarit të pasurisë si dhe listës së borxheve, për të paktën tetë orë (8) në ditë për pesë (5) ditët e punës para datës së shitjes.

39.6 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga krijimi i këshillit, ai duhet të bëjë publikimin e një lajmërimi, me masë jo më të vogël se gjysma e faqes në një gazetë me qarkullim të përgjithshëm në Kosovë, në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht, i cili duhet të përmbajë emrin e shoqërisë dhe të gjitha emrat tregtarë që dihen se janë përdorur nga shoqëria, njoftim në lidhje me kohën dhe vendin e shitjes publike apo kohën pas së cilës do fillojë shitja private, vendndodhjen e inventarit të pasurisë, listën e borxheve si dhe një deklaratë e cila parashtron se kur mund të bëhet kontrolli i inventarit të pasurisë dhe listës së borxheve. Lajmërimi gjithashtu duhet t'i përshkruajë kreditorëve të supozuar apo palëve të tjera të interesuara mënyrat se si mund t'i paraqesin ankesat e tyre.

39.7 Këshilli i likuidimit nuk mund të shlyejë asnjë nga pretendimet që nuk është përfshirë në listën e borxheve. Këshilli duhet të përcaktojë vlefshmërinë e çdo pretendimi para se ta përfshijë atë në listën e borxheve. Pretenduesit që preken nga kundërshtimi i këshillit për përfshirjen e ankesave në listën e borxheve mund t'i drejtohen gjykatës për të kundërshtuar këtë refuzim.

39.8 Këshilli nuk mund të shtyjë datën e shitjes të shpallur publikisht, por mund të caktojë një datë tjetër për shitjen në qoftë se ajo nuk ka përfunduar.

39.9 Këshilli duhet të shpërndajë të ardhurat nga shitja e pasurive të kompanisë në përputhje me prioritetet e shpërndarjes sipas ligjin në fuqi për falimentimin.

Neni 40

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë udhëzime administrative për zbatimin e kësaj rregullore.

Neni 41

Ligji i Zbatueshëm

Kjo rregullore shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të zbatueshëm të cilat janë në kundërshtim me të.

Neni 42

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 8 Shkurt 2001.

Hans Hakkerup

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm